



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 96-të të mbajtur më 27.11.2023, ka miratuar sa vijon,

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-2603/1 nga 23.05.2023, me pretendime për refuzim të pa bazë të aplikimit për marrje të bursës për student të rregullte, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim kompetent.

Lënda me numër 12-2603/1 nga 23.05.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Nga një parashtruesi i njohur më 23.05.2023, është dorëzuar denoncim me pretendime për refuzim të pa bazë të aplikimit për marrje të bursës për student të rregullt dhe u formua lënda me numër 12-2603/1 nga 23.05.2023.

Parashtruesi deklaroi se kishte paraqitur kërkesë për dhënie të bursës nga grupi i tretë për studentë të rregullt, të regjistruar në studimet universitare nga cikli i parë i universiteteve publike dhe institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e cila ishte refuzuar me vendim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Sipas arsyetimit të vendimit, studenti i plotësonte kushtet e parashikuara në konkurs, por nuk i jepet bursë sepse kandidati ka fituar 76.4 pikë dhe sipas renditjes, aplikacioni i fundit që përfiton bursë ka fituar 83 pikë. Po ashtu, parashtruesi thekson se vendimi është dorëzuar me shprehje të zakonshme dhe pranimiti nuk është vërtetuar me nënshkrim, dhe afati për

ankesë llogaritet nga dita e pranimet të të njëjtit. KSHPK-së i kërkohet të shqyrtojë pikëtimin dhe renditjen e listës, si dhe ankesën e përgjithshme të studentit.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja arrin në përfundimin se denoncimi nuk përmban pretendime të qarta për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar nga ana e personit zyrtar, si dhe kërkon veprim që është jashtë kompetencës së KSHPK-së në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsioni dhe konflikti i interesave.

Nga aty KSHPK-ja vlerësoi se nuk kishte elemente për veprim kompetent në rastin në fjalë, prandaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dërguar:

- Parashtruesi i denoncimit

përgatiti: B.K.SH .

miratoi: G.T anëtar i KSHPK-së.

**KOMISIONI SHETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**
Kryetar,
Biljana Ivanovska